



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal Kačanik

01 Nr. 16- 4838 /16
Kaçanik, 15.02.2016

RREGULLORE NR. 01/2016

**PËR PAGESËN E TARIFAVE, NGARKESAVE ADMINISTRATIVE,
GJOBAVE DHE SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE**

Shkurt , 2016

Në bazë të nenit, 5 lidhur me nenet, 12.1, 12.2(c), 40.2(a, g) dhe 17 të Ligjit nr. 03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-048 Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 dhe 8 të Ligjit nr. 03/L-049 Për Financat e Pushtetit Lokal, nenit 34.5. të Statutit të Komunës si dhe nenit 15.1(f) të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur me datë , 15 shkurt 2016, miratoj këtë:

RREGULLORE NR. 01/2016
PËR PAGESËN E TARIFAVE, NGARKESAVE ADMINISTRATIVE, GJOBAVE
DHE SHËRBIMEVE TË TJERA KOMUNALE

Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1.

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet lartësia e tarifave, ngarkesave administrative, gjobave dhe shërbimeve të tjera komunale të cilat u ofrohen qytetarëve dhe subjekteve afariste – biznesit në territorin e komunës së Kaçanikut.

Neni 2.

Kjo rregullore përcakton në veçanti secilën tarifë, ngarkesë dhe gjobë, detyrat dhe obligimet e çdo drejtorie dhe shërbimi së bashku me lartësinë dhe mënyrën e pagesës.

Tarifat dhe Ngarkesat

1. DREJTORIA E ADMINISTRATËS SË PËRGJITHSHME

Pjesa 1: Çertifikatat

Neni 3.

3.1 Dokumentet zyrtare:

1. Çertifikata e lindjës	1,00 €
2. Çertifikata e vdekjës	1,00 €
3. Çertifikata e martesës	1,00 €
4. Ekstrakti i lindjës.....	1,00 €
5. Çertifikata e Vendbanimit.....	1,00 €
6. Çertifikata e shtetësisë	1,00 €
7. Çertifikata e bashkësisë familiare	2,00 €
8. Çertifikata e statusit martesor.....	1,00 €

3.2 Dokumentet e konfirmuara :

1. Vërtetimi i çertifikatës me fotografi	2,00 €
2. Vërtetime nga arkivi i gjendjës civile.....	1,00 €
3. Regjistrimi i mëvonshëm i lindjeve në librat e gjendjës civile para vitit 2000	5,00 €
4. Regjistrimi i mëvonshëm i lindjeve në librat e gjendjës civile, pas vitit 2000 -	20,00 €
5. Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjeve në librat e gjendjës civile para vitit 2000-	5,00 €
6. Regjistrimi i mëvonshëm i vdekjeve në librat e gjendjës civile pas vitit 2000-	10,00 €
7. Anulimi i regjistrimeve të lindjeve të regjistruara dyfish etj.....	20,00 €
8. Dëshmi vdekje	5,00 €
9. Kërkesë për fitimin ose humbjen e shtetësisë me procedurë.....	5 .00 €
10. Korrigjimi i të dhënave personale në LAL, LAM, LAV dhe LSH.....	5,00 €
11. Korrigjimi i emrit personal	5,00 €
12. Ndërrimi i emrit apo mbiemrit ose bashkarisht.....	10,00 €
13. Lajmërimet dhe çlajmërimet e vendbanimit.....	2.00 €

3.3 Tarifa për ceremoni martesore:

3.3.1. Tarifa për ceremoni martesore (përfshirë dhe çertifikatën e martesës).....	10,00 €
3.3.2. Lidhja e kurorëzimit jashtë objektit të Adm.Komunale	50,00 €

3.4.Vërtetimi i dokumenteve zyrtare:

1. Vërtetimi zyrtar i nënshkrimeve, përshkrimeve, etj (kopjeve prej origjinalit)	1,00 €/faqe
---	-------------

3.5. Tarifat nga zyra e prokurimit:

1. Kërkesa për referencë nga prokurimi.....	5.00 €
2. Fotokopje të dosjeve të tenderit për aktivitet të prokurimit.....	2.00 € \ faqe

Neni 4.

Zyrtarët e deleguar nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme janë përgjegjës për kryerjen e këtyre shërbimeve në Zyret e Vendit, zyrtarët e deleguar do të bëjnë drejtpërdrejtë vjeljen, lëshimin e dëftesave dhe dorëzimin e pagesave në fund të çdo dy javëve. Sipas specifikacionit dorëzimin e pagesave do ta bëjnë në arkën kryesore të administratës komunale, si dhe barazimin reciprok me zyrtarët kompetent të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme dhe Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

Neni 5.

Me prezentimin e dëshmisë¹, nga pagesa lirohen:

1. Familjet e dëshmorëve lirohen nga pagesa e tarifave nga neni 3.1, 3.2, 3.3.1 dhe 3.4 të kësaj rregulloreje.
2. Shfrytëzuesit e ndihmës sociale, pensionistët, invalidët e luftës, veteranët e luftës, anëtarët e familjes së ngushtë të viktimave civile të luftës, antarët e ngushtë të familjeve të të zhdukurve të luftës, të burgosurit politik dhe personat me aftësi të kufizuara, lirohen nga pagesa e tarifave nga neni 3.1 dhe 3.2 nga pika 1 deri 9.
3. Anëtarët e ngushtë të familjeve të invalidëve të luftës dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të veteranëve luftëtar² lirohen nga pagesa e tarifave nga neni 3.1 të kësaj rregulloreje.
4. Komuniteti RAE, lirohen nga pagesa e tarifave nga neni 3.1, 3.2, 3.3 dhe 6.

¹ Barra e prezantimit të dëshmisë bie mbi parashtruesin e kërkesës.

² Anëtarë të familjes së ngushtë në kuptim të kësaj rregulloreje ka kuptimin si në nenin 1 pika 15 dhe 15.1 të ligjit Ligji Nr. 04/L-054, ku përfshihet: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët, fëmijët jashtëmartesor, fëmijët e adoptuar (birësuar), prindërit, njerka, njerku, thjeshtri, thjeshtja si dhe bashkëshorti/ bashkëshortja jashtëmartesor: 1.15.1. statusi i bashkësisë jashtëmartesor e sipas këtij ligji përcaktohet me procedurë gjyqësore jashtë kontestimore.

Neni 6.

6.1.Sektori i Arkivit Komunal :

1. Kërkesa për lëshuarjen e dëshmisë nga lënda arkivore	1,00 €
2. Lëshuarja e vërtetimit	3,00 €
3. Për gjetjen e lëndës arkivore para 06/1999	5,00 €
4.Për gjetjen e lëndës në arkivore pas 06/1999.....	3,00 €
5.Fotokopje të ndryshme – vetëm një faqe	gratis

Fotokopjimi i dokumentave për punë shkencore :

6. Një faqe A-4	0,10 €
7.Një faqe A-3	0,50 €
8. Një faqe A-0	1,00 €

Për çështjet private të rregullimit të të drejtave civilo-juridike :

9. Një faqe A-4	0,30 €
10. Një faqe A-3	0,50 €
11. Një faqe A-0	3,00 €

Për institucionet publike / private :

12. Një faqe A-4	2,00 €
13. Një faqe A-3.....	3,00 €
14.Shfrytëzimi i projekteve dhe materialeve tjera arkivore me procedurë të veçantë të sigurimit me përcjellje të punëtorit arkivore për një ditë.....	15,00 €
15. Llogaritja e përvojës (stazhit) së punës	10,00 €

2. DREJTORIA E URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Pjesa 3 : Shërbimet e gjeodezisë dhe kadastrit

Neni 7

7.1. TARIFAT E SHËRBIMEVE KOMUNALE KADASTRALE

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr.05/2012 dhe Nr.08/2014, nga AKK
Mbi të hyrat nga shërbimet Komunale Kadastrale

7.1.1. Për shërbimet e mirëmbajtjes së klasifikimit të tokave (klasët e kulturave):

Ndërrimi i kulturës në një ngastër pa matje	10,00 €
- për çdo ngastër tjetër që kufizohet me te	5,00 €
Ndërrimi i kulturës në një ngastër me matje	35,00 €
- për çdo ngastër tjetër që kufizohet me te	20,00 €

***Në fund palës i lëshohet vendimi.**

7.2. Ndarja e ngastrave:

Ndarja e një ngastre në dy pjesë me matje të pjesës së re deri 0.5 ha	60,00 €
- për çdo pjesë tjetër	25,00 €
Ndarja e ngastrës në pjesë të përcaktuara më parë	100,00 €
Ndarja në më tepër se dy pjesë të përcaktuara më parë, për çdo pjesë tjetër	35,00 €
Ndarja e një ngastre në dy pjesë me matje të pjesës së re dhe ripërtëritje të kufijve	100,00 €
- për çdo ngastër tjetër që kufizohet me te	25,00 €
Ndarja e një ngastre në dy pjesë me mbi 1 ha	80,00 €

♦ Ndarja e komplekseve me sipërfaqe prej 5 –10 ha në dy (2) pjesë	200.00 €;
♦ Për çdo ndarje në pjesë tjetër	100.00 €;
♦ Ndarja e komplekseve me sipërfaqe mbi 10 ha, në dy (2) pjesë	500.00 €;
♦ Për çdo ndarje në pjesë tjetër	200.00 €;

Ngastra e re regjistrohet në planin kadastral dhe regjistër. Palës i lëshohet vendimi, kopja e planit dhe fleta poseduese.

7.3. Rilevimi i sipërfaqes së ndërtesave:

Ndërtesat individuale – për një ndërtesë	50,00 €
Për çdo objekt tjetër në të njëjtën ngastër	20,00 €
Ndërtesat shumkatëshe – për një ndërtesë	100,00 €
Objektet më të vogla që i takojnë ndërtesës shumkatëshe - për një objekt.....	40,00 €
Ndërtesat e ndërlikuara – për një orë pune	10,00 €

***Palës i lëshohet vendimi, kopja e planit dhe fleta poseduese.**

7.4. Përtëritja e kufijve të ngastrës:

Për ngastrën me sipërfaqe gjerë në 0.50 h	80,00 €
Për ngastrën me sipërfaqe prej 0.50 h gjerë 1.00 h	100,00 €
Për çdo ngastër tjetër që kufizohet me te	50,00 €
Për rrugë, hekurudhë, kanale në gjatësi gjerë në 100 m	150,00 €
Për çdo metër gjatësi shtesë - edhe	0,50 €

***Palës i lëshohet vendimi dhe skica në të cilën shifet përtëritja e kufijve.**

7.5. Punët në matje sipas kërkesave të posaçme:

Bartja e planeve urbanistike ne terren per nje ngaster	80,00 €
Puna ne zyre per ndarjen e sipasplaneve urbanistike-per nje ngaster	20,00 €
Shenimi i vijes se rregullacionit te rruges-per nje meter	0.50 €

7.6. Shënimi i kufijve në terren me rastin e eksproprijimit:

Shënimi dhe matja e kufijave - për 1 metër gjatësi	0,80 €
--	--------

7.7. Identifikimi i ngastrave dhe objekteve kadastrale ne zyre:

Identifikimi i numrave të ngastrave dhe pronarëve	10,00 €
Për çdo ngastër tjetër shtesë	5,00 €
Identifikimi i një ngastre pa matje – për një ngastër	30,00 €
Identifikimi i një parcele–krahasimi i gjendjes së re me të vjetrën (në z y	15,00 €

♦ **Palës i lëshohet konstatimi (këshilla) e ZKK-së.**

7.8 Punët tjera gjeodezike:

Përpilimi i skicave për strukturën e banesës	40,00 €
Matja e gypave, përçuesëve elektrik dhe përçojave tj.-për një metër gjatës.....	0,80 €
Koordinatat, lartësia mbidetare, përshkrimi i pozitës, çmimi per nje pikë	10,00 €
Vendosja e një pike gjeodezike	30,00 €
Per çdo pikë tjetër edhe	10,00 €

7.9. Koordinatat (y,x,z) dhe përshkrimi i pozitës së pikave gjeodezike, çmimi për një pikë:

Koordinatat, lartësia mbidetare, përshkrimi i pozitës, çmimi për një pikë	10,00 €
Vendosja e një pike gjeodezike (stacioni i lirë)	30,00 €
Për çdo pikë tjetër	10,00 €

7.10. Kopja e planit kadastral: paraqitja vertikale :

Për planin në shkallë 1:500	25,00 €
Për planin në shkallë 1:1000	30,00 €
Për planin në shkallë 1:2500	30,00 €
Për planin në shkallë 1:5000	25,00 €

7.11. Sherbimet administrative

Leshimi i fletave poseduese për fletën e parë	3,00 €
Per çdo fletë tjetër të fletës poseduese	1,00 €

Çertifikatat për një ekstrakt	2,00 €
Regjistrimi, ndrrimi, bartja, fshirja e poseduesit të paluajtshmerisë	20,00 €
Kopja e planit formati A4 për një kopje	5,00 €
Kopja e planit formati A3 për një kopje	7,00 €

7.12. Punët tjera sipas kërkesave të palëve:

Puna në zyrë, për një orë	10,00 €
Puna në terren, për një orë	30,00 €

Në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr.06/2008 të MSHP-së – Për tarifat e shërbimeve dhe të produkteve kadastrale të ofruara nga Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK) dhe kompanitë gjeodete të licencuara

Për ndrrimin e kulturave me matje gjeodezike	35,00 €
Bashkimi i parcelave me matje në teren	80,00 €
Kopja e planit në formatin A3	7,00 €
Identifikimi i parcelës në zyrë	10,00 €
Bartja e shënimeve nga terreni të dhënave nga planet urbanistike për objekte individuale	0,50 €

UDHËZIMI ADMINISTRATIV Nr.AKK 2006/1

Mbi përcaktimin e nivelit të pagesave për Shërbimet e bëra për RDPP

7.13 Regjistrimi i Pronësisë, posedimit - transaksionet - shitëblerjet

7.13.1 Deri më 10.000 €, taksa	20,00 €
7.13.2 Prej 10.000 – 20.000 € taksa	30,00 €
7.13.3 Prej 20.000 – 40.000 € taksa	40,00 €
7.13.4 Prej 40.000 – 50.000 € taksa	50,00 €
7.13.5 Mbi 50.000 € për euro + 10 euro, por shuma e përgjithëshme e taksës nuk mund ta kalojë vlerën prej	200,00 €

7.14. Regjistrimi i pronës mbi dhuratën

7.14.1 Nëse caktohet vlera e dhuratës – tarifa paguhet sipas pikës; 1.1; 1.2; 1.3; 1.4 dhe 1.5.

7.14.2 Nëse nuk caktohet vlera e dhuratës për çdo pronar shuma e taksës që duhet paguar është..... **40,00€.**

7.15. Regjistrimi i pronës, posedimit të dokumentit në bazë të organeve administrative dhe gjyqësore

7.15.1. Duhet të paguhet tarifa në shumë prej..... **80,00 €.**

7.16. Regjistrimi i pronës sipas ndarjes së pronës në bashkëpronësi:

7.16.1 Në bazë të ndarjes të pronës na bashkëpronësi tarifa paguhet për secilin pronar nga**20,00 €.**

7.17. Regjistrimi i pronës në bazë të trashëgimisë dhe shkëputjes së bashkësisë familjare:

7.17.1 Në bazë të trashëgimisë dhe shkëputjes së bashkësisë familjare tarifa paguhet për secilin trashëgimtar dhe anëtar të familjes që bëhet pronar në shumë prej..... **20,00 €.**

7.18. Regjistrimi i pronës në bazë të ndërrimit:

7.18.1 Regjistrimi i pronës në bazë të ndërrimit bëhet pagesa e tarifës në shumë prej..... **50,00 €.**

7.19. Regjistrimi i Hipotekave:

7.19.1 Deri më 5.000 € paguhet taksa	20,00 €
7.19.2 prej 5.000 – 10.000 € paguhet taksa	30,00 €
7.19.3 prej 10.000 – 20.000 € paguhet taksa	50,00 €
7.19.4 prej 20.000 – 40.000 € paguhet taksa	70,00 €
7.19.5 Mbi 40.000 për çdo 10.000 € tejkalim +20 € por vlera e përgjithëshme nuk mund ta kalojë.....	 300,00 €

7.20. Fshirja e Hipotekës

7.20.1 Për çdo fshirje të hipotekës paguhet taksa në shumë prej **20,00 €**

7.21. Regjistrimi i Servituteve:

7.21.1 Për regjistrimin e servituteve paguhet taksa në shumë prej	 40,00 €
7.21.2 Për fshirjen e servituteve paguhet taksa në shumë prej	 20,00 €

7.22. Qirambajtja:

7.22.1 Qirambajtje prej 3 – 10 vite paguhet shuma prej	 30,00 €
7.22.2 Qirambajtje prej 10 – 25 vite paguhet shuma prej	80,00 €
7.22.3 Qirambajtje prej 99 vite paguhet shuma prej	200,00 €

Fshirja e të drejtës së shfrytëzimit – qirambajtja bëhet duke paguar gjysmën e shumës që është paguar për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit

7.23. Regjistrimi i të drejtave të tjera:

7.23.1 Paguhet tarifa në shumë prej	40,00 €
---	---------

7.24. Regjistrimi i përçojave:

7.24.1 Regjistrimi i përçojave do të bëhet duke paguar tarifën në shumë prej 0.15 euro për metër gjatësi.
--

7.24.2 Gjatësia e përçojes do të konfirmohet nga projekti.

Neni 8.

Dispozitat e Veçanta

8.1. Për punë në terren prej 15 Nëntorit gjerë me 15 Mars çmimet janë më të larta për 25%;

8.2. Për punët dhe shërbimet që do të kryhen në tokat pyjore çmimet do të jenë më të larta për 10 %;

8.3. Pala duhet të paguaj apo sigurojë transportin dhe punëtorët ndihmës për punë në terren.

Nëse ZKK-ja e siguron transportin, çmimi është 0,50 € për 1 km.

8.4. Pala duhet më parë të paguaj për shërbime apo produkte nëse ZKK-ja kërkon një gjë të tillë.

8.5. Pagesat dhe shpenzimet e transportit do të paguhet drejtëpërdrejtë në konton bankare të komunës.

Pjesa 4 : Tarifat dhe ngarkesat për ndërtim dhe urbanizëm

Neni 9

9.1. Lejet e ndërtimit dhe rregullimi i tokës ndërtimore

9.1.1. Taksa për Leje ndërtimore për objekte individuale, kolektive të banimit, objekte afariste e biznesore	1.20 €/m ²
--	-----------------------

*** Nga taksat për leje ndërtimore lirohen këto kategori:**

1. Anëtarët e familjeve të dëshmorëve si dhe kategoritë të cilët përfitojnë sipas Ligjit për kategoritë e dala nga lufta (për objekte të kategorisë së parë);
2. Objektet bujqësore të cilat subvencionohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës; dhe,
3. Objektet të cilat ndërtohen në mënyrë humanitare (e cila dëshmohet), për objektet e kategorisë së I-rë.

* 1. Taksa prej njëqind (100) Euro e cila paguhet me rastin e aplikimit, për objektet e kat.I,II,III, do t'i zbritet shumës së pagesave të mbetura borxh sipas paragrafit 9.1.2.
--

9.1.3 Taksa për rritje të densitetit 119.10 €/banor (vetëm për objektet e kategorisë së dytë) sipas udhëzimit administrativ

9.1.4. Pompat e benzines (për m ³ të kapacitetit të rezervuarëve të derivateve)	50.00 €
9.1.5. Fushat e përkohshme sportive	1500.00 €
9.1.6. Vendosja e antenave – transmetuesëve të ndryshëm si telefonisë celulare, fikse, internetit	500.00 €;
9.1.7. Për centralet elektrike me fuqi prodhuese të rrymës deri në 20 MËH	1000 €/MWH
9.1.8. Për pishinat verore	10.00 €/m ²
9.1.9. Për bazene për kultivim të llojeve të ndryshme të peshqëve	2,00 €/m ²
9.1.10. Për ndërtimin e rrjetit kabllorik	1.00 €/m'
9.1.11- Për ndërtimin e fabrikave për prodhimin e betonit – betonierkat,	10 €/ m ³ të rezervuarëve të vendosur për prodhim të betonit.

2. Nga taksa për legalizim lirohen shtëpitë individuale të banimit deri njëqind metra katrorë (100 m²), përfutjesit e skemës sociale dhe objektet bujqësore deri katërqind metra katrorë (400 m²) sipas nenit 10 nën-paragrafi 1.2. të **Ligjit Nr. 04/L-188**, Mbi trajtimin e ndërtimeve pa leje.

9.1.12 Kësaj i shtohen edhe tarifat për objekte përcjellese dhe ato sipas pikës 9.1.11 dhe 9.1.2

Vërejtje: Sasia për m², llogaritet për gabaritin e jashtëm të objektit.

Për adaptim, rekonstruim të objekteve ndërtimore paguhet 50%, e taksave për leje ndërtimi.

Hapsira e podrumit llogaritet në tarifë prej 50%, të hapsirës së banimit

9.2. Tarifat dhe ngarkesat për lejet mbi shfrytëzimin e objekteve caktohen në lartësi prej 20% të vlerës së tarifave dhe ngarkesave për leje ndërtimi;

9.3. Tarifa për dhënie të Lejes mjedisore komunale duke u bazuar në nenin 12 të Udhëzimit administrativ Nr.17/2015, për dhënie të Lejes mjedisore komunale, dhe atë 0.20 % të vlerës investuese të projektit.

9.4. Qiraja në pronësi të lokaleve pronë e KK.Kaçanik, (për m²/ muaj):

Sipërfaqja deri në 50 m ²	2,50 €
Sipërfaqja deri në 100 m ²	2,00 €
Sipërfaqja më mbi 100 m ²	1,50 €

9.4.1 Sipërfaqet ndihmëse të lokaleve (kuzhinat, depot etj)0,50 €

Vërejtje : Investimi i shfrytëzuesve të përkohshëm të lokaleve pronë komunale në adaptimin-e lokalit për përmirësimin e kushteve të punës, në lokal zbritet nga ngarkesa vjetore e qirasë. Vlerësimi i kostos financiare, bëhet nga Komisioni i formuar nga Kryetari i Komunës.

9.5. Qiraja për shfrytëzimin e tokës, pronë e komunës për biznes

9.5.1. Objektet e përkohshme (për m² / muaj):

Zona I	0.60 €
Zona II	0.50 €
Zona III	0.40 €
Zona IV	0.30 €

Vërejtje: Ndalohet dhënja e pronës së komunës nga shfrytëzuesi kontraktues personit tjetër për shfrytëzim – në rastet e gjetura shfrytëzuesi kontraktues do të humb të drejtën në shfrytëzim, sespse këtë të drejtë e ka vetëm komuna si titullar i pronës;

Qiraja sipas pikës 9.4.1. vlenë për katin përdhësë. Për katet tjera vlera e qirasë llogaritet sa 50% e qirasë për katin përdhësë.

9.6. Qiraja për shfrytëzim të tokës ndërtimore për banim dhe destinim tjetër për m²/ vit.

Për banim	0,50 €
Për garazha	2,00 €
Për destinim tjetër – parkim	6,00 €

Për objektet deri më 100 m ²	10,00 €
Për objektet prej 101 – 500m ²	20,00 €
Për objektet prej 501 – 1000m ²	30,00 €
Për objektet prej 1001 – 2000m ²	40,00 €
Për objektet më të mëdha, për çdo 1000 m ² , tarifa rritet për	10,00 €

9.7. Për lëshimin e vërtetimit në caktimin e vlerës së objektit:

Vlerësimi bëhet nga Komisioni për vlerësime të pasurisë i formuar nga Kryetari i komunës

9.8. Për daljen në teren sipas kërkesave	5,00 €
--	--------

Vërejtje: Përfshihen rastet e daljes në teren gjatë shqyrtimit të kërkesave për leje ndërtimi dhe përdorimi,

skemave sociale, anëtarët e familjeve të dëshmorëve si dhe kategoritë të cilët përfitojnë sipas Ligjit

për kategoritë e dala nga lufta (për objekte të kategorisë I-rë);

9.9. Për lëshimin e ekstrakteve nga planet urbanistike	10,00 €
9.10. Për dhënjen e Pëlqimeve të ndryshme	10,00 €
9.11. Për ndarje fizike të ngastrës kadastrale	10,00 €
9.12. Lëshimi i vërtetimeve të ndryshme	1,00 €
9.13. Dhënia e Vërtetimeve që Komuna nuk është e interesuar për blerje të patundshmërive	5.00 €
9.14. Dhënia e Njoftimeve në bazë të kërkesave të ndryshme	10.00 €

Pjesa 5. Vlerësimi i pronës së paluajtshme

Neni 10.

10.1. Tarifat dhe ngarkesat për vlerësimin e vlerës së kontratave të pasurisë së paluajtshme
..... 50,00 €

Pjesa 6. Dënimet dhe gjrobat për ndërtim dhe urbanizëm

Neni 11.

Masat ndëshkuese apo dënimet të cilat duhet t'i zbatoj zyrtari i deleguar, përkatësisht Inspektori i ndërtimtarisë janë të përcaktuara me nenin 35 të Ligjit mbi Ndërtimin 04/L-110, të miratuar në Kuvendin e Kosovës.

Pjesa 6.1. Dënimet nga Inspektori i ndërtimit

Në bazë të nenit 35 - Kundërvajtjet nga pronari- në Ligjin 04/L-110- Mbi ndërtimin,

1. Mënyra, procedurat, ekzekutimi dhe shumat e gjobave ndaj pjesëmarrësve në ndërtim përcaktohen nga ministria me akt të veçantë administrativ dhe rishikohet dhe miratohet për çdo vit dhe publikohen në Gazetën zyrtare.
2. Poseduesi i lejes ndërtimore do të gjobitet nëse:
 - 2.1. puna ndërtimore krijon rrezik për personat tjerë, dhe nëse nuk siguron, rrethon ose shënjon dukshëm me shenja treguese rreziqet që mund t'u kanosen kalimtarëve;
 - 2.2. Nuk vendos në vendndërtim tabelën informuese, apo
 - 2.3. Nuk ndërmerr masa për sigurimin e ndërtimit dhe ndërtimeve fqinje.

Pjesa 6.2. Dispozitat ndëshkimore:

Në bazë të nenit 49 - Kundërvajtjet, të Ligjit 04/L-175, Mbi inspektortin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapsinor dhe ndërtimit;

1. Me gjobë në të holla prej njëmijë (1.000) deri në pesëmijë (5000) Euro, gjobitet për kundërvajtje personi juridik, kurse pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) Euro, gjobitet personi përgjegjës i personit juridik, nëse:
 - 1.1. Nuk vepron sipas kërkesës, përkatësisht afatit të caktuar me urdhër të inspektorit, sipas nenit 27, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1. të këtij ligji;
 - 1.2. Inspektorit nuk i mundëson kryerje të papenguar të mbikëqyrjes inspektuese, sipas nenit 27 paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. të këtij ligji;
 - 1.3. Inspektorit nuk i ofron dokumentacionin dhe të dhënat e nevojshme për procedurë të mbikëqyrjes inspektuese, sipas nenit 27 paragrafi 1. nën paragrafi 1.3. të këtij ligji;
 - 1.4. Inspektorit nuk i siguron kushte të nevojshme për kryerjen e procedurës inspektuese, sipas nenit 27 paragrafi 1. nën paragrafi 1.4. të këtij ligji;
 - 1.5. Inspektorit nuk i mundëson qasje në hapësira punuese dhe pajisje për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese, sipas nenit 27 paragrafi 1. nën paragrafi 1.5. të këtij ligji;

1.6. Nuk kryen veprimet e detyruara gjatë procedurës inspektuese, për të vlerësuar gjendjen faktike, sipas nenit 27, paragrafi 1. nën paragrafi 1.7. të këtij ligji;

1.7. Në afatin e caktuar, nuk i dorëzon ose përgatitë të dhënat, raportet, materialet dhe dokumentet tjera të nevojshme për procedurën e mbikëqyrjes inspektuese, sipas nenit 27 paragrafi 1. nën paragrafi 1.8. të këtij ligji;

1.8. Në afatin e caktuar nuk zbaton masat e urdhëruara nga inspektori, përkatësisht nuk e informon atë me shkrim për kryerjen dhe zbatimin e atyre masave të urdhëruara, sipas nenit 29 paragrafi 2, të këtij ligji;

1.9. Për dyshimet e bazuara nga ana e inspektorit për ndonjë veprimtari të dyshuar që mund të jetë subjekt i inspektimit, nuk i mundësohet inspektorit kryerjen e kontrollit dhe mbikëqyrjen inspektuese, sipas nenit 30 të këtij ligji;

1.10. Subjekti i mbikqyrës nuk zbaton kërkesat dhe afatin e përcaktuar në njoftimin për pezullimin e veprimtarisë nga inspektorati, sipas nenit 25 të këtij ligji.

2. Me gjobë në të holla prej pesëmijë (5000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik kurse pesëqind (500) deri në njëmijë (1.000) Euro personi përgjegjës i personit juridik në organin kompetent në nivel qendror dhe lokal, sipas nenit 22, nënparagrafit 1.2. të këtij ligji.

3. Me gjobë në të holla prej pesëmijë (5.000) deri në dhjetëmijë (10.000) Euro gjobitet për kundërvajtje personi juridik dhe pesëqind (500) deri në njëmijë (1000) Euro personi përgjegjës në nivel lokal, sipas nenit 22 nënparagrafit 1.3. të këtij ligji.

Pjesa 6.3. Kundërvajtjet dhe gjobat

Në bazë të nenit 5, 6, të Udhëzimit administrativ të MMPH-së, Nr. 20/2013, Për mënyrën, procedurat, dhe shumën e gjobave ndaj pjesëmarrësve në ndërtim që kanë të bëjnë me zbatimin dhe vlerën e denimeve kunder aplikuesve të lejeve të ndërtimit, poseduesve të lejeve të ndërtimit, projektuesve, dhe kontraktuesve për shkeljen e Ligjit për Ndërtim, Nr.04/L-110 dhe Kodit Unik të Ndërtimit për Republikën e Kosovës, si dhe Udhëzimet Administrative për zbatimin e Ligjit.

6.3.1. Ndërtimi pa leje.

Nese kerkohet nje leje per pune ndërtimore :

1.1. Çdo pronar i parcelës kadastrale i cili nderton apo lejon të ndertohen ndertesa pa leje ndërtimi për atë parcelë i nënshtrohet një gjobe prej:

- 500 € deri në 2.000 €, (kategoria I),
- 2.000 € deri në 5000 € (kategoria II) dhe,
- 5.000 € deri në 10.000 € (kategoria III);

1.2. Çdo kontraktues i cili kryen punët ndërtimore për të cilat nuk është lëshuar një leje për ndërtim i nënshtrohet gjobës prej:

- 500 € deri në 1.000 €, (kategoria I),
- 1.000 € deri në 3.000 € (kategoria II) dhe,
- 2.000 € deri në 6.000 € (kategoria III);

1.3. Çdo projektues, arkitekt ose inxhinier i cili ofron shërbime profesionale për një punë ndërtimore pasi të ketë filluar puna ndërtimore atehere kur nuk është lëshuar leja ndërtimore, i nënshtrohet një gjobe prej 200 € deri në 500 €.

6.3.2. Shkelja e kushteve të lejës:

6.3.2.1. Çdo poseduesi të lejës, i cili shkel kushtet e lejës të lëshuar në baë të nenit 15 apo 18 të Udhëzimit Administrativ Nr. 10/2013 për caktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve për kushtet e ndërtimit dhe lejet e ndërtimit do t'i jepet një mundësi për të korrigjuar shkeljen në pajtim me nenet 18 dhe 19 të Udhëzimit Administrativ për Standardet Minimale dhe Procedurat për Mbikëqyrje Inspektive dhe Lëshim të Çertifikatës së Përdorimit;

6.3.2.2. Nëse vazhdohet me moskorrigjimin e shkeljes do t'ia nënshtrojnë poseduesin e lejës ndeshkimeve sipas nenit 17 të Udhëzimit Administrativ për Standardet Minimale dhe Procedurat për Mbikëqyrje Inspektive dhe Lëshim të Çertifikatës së Përdorimit;

6.3.3. Ri-inspektimi.

Një gjorbë për ri-inspektimin e punës ndërtimore, në vlerë prej 50 € mund t'i percaktohet poseduesit të lejës apo kontraktuesit, nëse:

6.3.3.1. Objekti apo faza që kërkohet të inspektohet nuk janë gati;

6.3.3.2. Planet e miratuara apo kartela e inspektimeve të miratuara nuk ishte në dispozicion;

6.3.3.3. Dokumentacioni i nevojshëm nuk ishte prezent në vendndërtim;

6.3.3.4. Nuk është ofruar qasja në vendin e inspektimit;

6.3.3.5. Njoftimi paraprak për korrigjim nuk gjendej në vendndërtim për ri-inspektim;

6.3.3.6. Ndonje pike nga njoftimi paraprak për korrigjim nuk është kryer; apo,

6.3.3.7. Puna nuk është gati apo nevojiten korrigjime dhe inspektori pajtohet të presë në vendpunishte për të lejuar kohë që puna të kryhet apo të bëhet korrigjimet.

6.3.4. Refuzimi për t'u përmbajtur urdhrit të duhur të inspektorit.

Çdo person fizik apo juridik që vazhdon punët pasi të jetë lëshuar një urdher për ndaljen e punës, largon shiritin e inspektorit apo njoftimin për ndaljen e punës, apo ndryshe deshton që t'i përmbahet çfarëdo urdhri të ligjshëm të një inspektori është subjekt i një gjore prej:

6.3.4.1. 1.000 €; (kategoria I) ,

6.3.4.2. 5.000 € (kategoria II) dhe,

6.3.4.3. 10.000 € (kategoria III).

6.3.5. Refuzimi për të marrë certifikatën e përdorimit.

Pronari i objektit ndërtimor që ka filluar përdorimin pa e marrë certifikatën e përdorimit apo certifikatën e perkohshme të përdorimit t'është subjekt i gjores prej 2,000.00 € deri në 5,000.00 €.

6.3.6. Zbatimi

1. Inspektori i ndërtimit mund të shqiptojë gjobën aty për aty personit fizik dhe juridik në shumën prej 100 €

deri në 500 €, e cila është e pagueshme deri në afat prej shtatë (7) ditësh .

2. Gjjobat që tejkalojnë 500€, do të dorëzohen në Gjykatën kompetente të iniciuar nga organi kompetent.

3. Nëse personi fizik ose juridik nuk sjellë deshmime e pageses së kryer në afatin e caktuar nga organi kompetent lenden e procedon në Gjykatën kompetente.

6.3.7. Dënimet dhe gjobat nga Inspektorati mjedisor

Në bazë të nenit 16 - Dispozitat ndëshkuese dhe gjobat mandatore, të Udhëzimit administrativ i MMPH-së, Nr.14/2015, Për ndëshkimet me gjoba mandatore

1. Veprimet ndëshkuese me gjobë mandatore dhe vlera e gjobës për personin janë:

1.1. Me gjobë në vlerë prej 5 €, i shqiptohet dënimi personit nëse:

- 1.1.1 Hedhë cigaren në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.1.2 Hedhë çamçakëz në rrugë ose në sipërfaqe publike;

1.2 me gjobë në vlerë prej 10 €, i shqiptohet dënimi personit nëse:

- 1.2.1. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina letre në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.2 Hedhë ambalazhë dhe mbeturina plastike në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.3. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina qelqi në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.4. Hedhë kanaçe në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.5. Hedhë mbeturina ushqimore në rrugë ose në sipërfaqe publike;
- 1.2.6. Si kalimtar rasti hedhë çfarëdo lloj mbeturine në rrugë ose në sipërfaqe publike.

1.3. Me gjobë në vlerë prej 20 €, i shqiptohet dënimi personit nëse:

- 1.3.1. Hedhë mbeturina komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale;
- 1.3.2. Hulumton nëpër kontejner të mbeturinave, merr ose shkapërderdh-hedhë mbeturina prej kontejnerit jashtë.
- 1.3.3. Hedhë mbeturina të përziera në kontejnerët ku janë të klasifikuara mbeturinat si:
 - 1.3.3.1. Organike, qelqi, letra, plastika, metali,
 - 1.3.3.2. Mbeturinat nga copëtimi i drunjëve i lenë në rrugë ose në sipërfaqe publike;
 - 1.3.3.3. Nuk e pastron jashtëqitjen e kafshës së tyre në rrugë, trotuare, parkingje, objekte të banimit kolektiv dhe objekte tjera banimi.

1.4. Me gjobë në vlerë prej 30 €, i shqiptohet dënimi personit nëse:

- 1.4.1. Hedhë cigare në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.2. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina letre në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.3. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina pastike në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.4. Hedhë ambalazhë dhe mbeturina qelqi në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.5. Hedhë kanaçe në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.6. Hedhë mbeturina ushqimore në rrugë nga automjeti në lëvizje;
- 1.4.7. Dëmton kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.8. I ndërron vendin kontejnerëve për mbeturina komunale;
- 1.4.9. Hedhë akumulatore në kontejnerët për mbeturina komunale
- 1.4.10. Hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.4.11. Hedhë mbeturina të automjeteve të vjetra në kontejnerët për mbeturina komunale, rrugë, në natyrë dhe sipërfaqe publike;
- 1.4.16. Hedhë mbeturina ushqimore në natyrë;
- 1.4.17. Hedhë mbeturina nga kopshtet në kontejnerët për mbeturina komunale;

1.5. Me gjobë në vlerë prej 50 €, i shqiptohet dënimi personit nëse:

- 1.5.1. Hedhë çfarëdo lloj mbeturine nga ballkoni ose dritarja e objektit;
- 1.5.2. Hedhë mbeturina në pusetat për kanalizim;

- 1.5.3. Hedhë mbeturina nga ambalazha e materialit ndërtimor jashtë kontejnerëve (ambalazhë letre, metali, plastike dhe materiale të ndryshme)
- 1.5.4. Hedhë mbeturina të ngjyrave në kanalizim;
- 1.5.5 Hedhë mbeturina të ngjyrave në kontejnerat për mbeturina komunale;
- 1.5.7. Hedhë mbeturina medicinale në kontejner për mbeturina komunale;
- 1.5.8. Hedhë mbeturina të stallave në afërsi të rrugës brenda vendbanimit (nuk nënkupton shpërndarjen e plehut në ara)
- 1.5.10. Hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.5.11. Hedhë bateri ose akumulator në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.5.12. Hedhë cigaren e ndezur në kontejnerin për mbeturina komunale;
- 1.5.13. Hedhë hirin e nxehtë në kontejnerin për mbeturina komunale;

1.6. Me gjobë në vlerë prej 70 €, i shqiptohet dënimit nëse:

- 1.6.1. Hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore jashtë vendeve ose ndërtimore jashtë vendeve ose kontejnerëve të caktuar nga autoriteti komunal për mbeturina të materialeve ndërtimore;
- 1.6.2. Hedhë mbeturina nga materialet ndërtimore në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.6.3. Hedhë mbeturina medicinale në sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.6.4. Hedhë mbeturina medicinale jashtë kontejnerëve për këto lloje të mbeturinave;
- 1.6.5. Hedhë mbeturina të vëllimshme në kontejner për mbeturina komunale, sipërfaqe publike ose në natyrë;
- 1.6.6. Hedhë lloj tjetër të mbeturinave në sipërfaqe publike ose në natyrë
- 1.6.7. Hedhë mbeturina të përziera me vaj në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.6.8. Mbeturinat drunore nga krasitja e bimëve ose drunjëve nuk i mbledh nga rruga ose hapësira publike në kohën e krasitjes;
- 1.6.9. Hedhë mbeturina drunore nga krasitja e bimëve ose drunjëve në kontejnerët për mbeturina komunale;
- 1.6.10. Djegë mbeturina komunale në kontejner;

1.7. Me gjobë në vlerë prej 100 €, i shqiptohet dënimi personit nëse:

- 1.7.1. Hedhë çfarëdo lloj mbeturine në ujëra të përroskave, lumenjve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
- 1.7.2. Hedhë çfarëdo lloj mbeturine në brigjet e përroskave, lumenjve, liqeneve ose sipërfaqeve të tjera me ujë;
- 1.7.3. Hedhë mbeturina të vajit në sipërfaqe publike, kanalizim, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.4. Hedhë mbeturina të përziera me vaj në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.5. Hedhë mbeturina të gomës dhe goma të automjeteve në sipërfaqe publike në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.6. Djegë mbeturina komunale në sipërfaqe publike, në rrugë ose në natyrë;
- 1.7.7. Djegë goma, goma të automjeteve ose mbeturina tjera prej gome, në hapësira private, publike në rrugë ose në natyrë;
